



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11.5.2023

Nr: 497

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 408, NGA Z.IVI KASO PËR HAPIEN E ZYRËS ZGJEDHORE NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË" AFËR KZAZ-SË, BASHKIA TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 11 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

KËRKUES: z. Ivi Kaso

OBJEKTI: Kërkohet marrja e masave të menjëhershme, përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për hapjen e zyrës zgjedhore nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" afër KZAZ-së nr. 29, Bashkia Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", e pika 2, neni 79, pika 3, i Kodit Zgjedhor si dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 11.5.2023 Nr: 497
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 408, nga z. Ivi Kaso për hapjen e zyrës zgjedhore nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" afër KZAZ-së, Bashkia Tiranë, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 maj 2023."

KONSTATOJ:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me denoncues Z. Ivi Kaso. Denoncimi është regjistruar me nr. 408 ID, datë 10.5.2023, të regjistrit të denoncimeve. Nëpërmjet këtij denoncimi pretendohet se ;”*Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” ka hapur zyrë zgjedhore në një distancë shumë afër me vendndodhjen e KZAZ nr. 29, Shkolla 9-vjeçare Katund i Ri.”*

Pala kërkuese kërkon marrjen e masave të menjëhershme përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për këtë qëllim, lidhur me veprimet e kryera, sipas provave të paraqitura.

Në përgjigje të këtij denoncimi, KQZ filloi hetimin administrativ përkatës. Në kuadër të këtij hetimi administrativ, monitoruesit të caktuar nga KQZ – ja në Bashkinë Tiranë, nëpërmjet postës elektronike e-mail, ju kërkua informacion në lidhje me zyrën zgjedhore të “Partisë Socialiste të Shqipërisë” në shkollën 9 vjeçare Katund i Ri.

Nga informacioni i dërguar nga monitoruesi, zyra zgjedhore rezultoi afërsisht 10 metra nga KZAZ nr. 29, Shkolla 9 vjeçare Katund i Ri, si dhe nuk përmban shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të” (vijon emri i subjektit zgjedhor).

Raporti i monitoruesit është i shoqëruar me foto të zyrës zgjedhore.

Nga analiza ligjore, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve nga denoncuesi, si dhe raporti i monitoruesit vlerësojmë se zyra zgjedhore është vendosur në kundërshtim të nenit 79, pika 3, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 5, pika 1 të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, e pika 2, nenin 79, pika 3, të Kodi Zgjedhor si dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake, për mbylljen e menjëhershme të zyrës afër KZAZ nr. 29, Kasha.
2. Ngarkohen subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Tiranë për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.
3. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Tiranë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI